

RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

SHOQERIA “CLAUDIO GROUP” sh.p.k.

“PRODHIM PELLETI”



**Punoi: Besim Doci
Ekspert Mjedisor**

Maj, 2014

PERMBAJTJA

1-HYRJE

2-KUADRIT LIGJOR

3-TE DHENA TE PERGJITHSHME PER SHOQERINE

4-RELACIONI TEKNIK

5-KARAKTERISITKAT E ZONES KU DO TE KRYHET AKTIVITETI

6-GJENERIMET E NDOTJEVE NE MJEDIS, MASAT PER PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E TYRE

7- PLANI I MONITORIMIT

8-PLANI I PERBALLIMIT TE EMERGJENCAVE

9-REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE

10-SHTOJCAT

1 – HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne cdo aspekt te vetin, pervec dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe "produkte" qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrushem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proves. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizike dhe human te aktivitetit "PRODHIM PELLETI", gjate fazes ndertimore dhe te funksionimit te kompleksit. Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

Ndikimi efekti i nje projekti qe ka ne mjedisin rrethues Vleresimi —> analiza qe i behet ketij projekti Mjedis —> elementet abiotike dhe biotike

VNM perfshin gjithashtu parashikiinin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit. Mbrojtja e mjedisit, si nje sistem dinamik, duhet pare ne teresine e faktoreve natyror, dhe te veprimit njerezor qe ushtrohen mbi te. Ato kane nje efekt te fuqishem mbi kushtet e jeteses se popullsise, dhe jane nje element baze per krijime te favorshme ekonomike.

2 - KUADRI LIGJOR

Hartimi i ketij Raporti te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, ka marre parasysh dhe eshte mbeshtetur ne legjislacion mjedisor si me poshte:

Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" i ndyshuar

Ligjin nr. 10440, date 23/01/2003 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligjin Nr. 10448, date 14/07/2011 "Per lejet e mjedisit",

Ligji Nr.8897, date 16/05/2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji Nr.9774, date 12/07/2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"

Ligji Nr.9010, date 13/02/2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"

Ligji Nr.9587, date 20/07/2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit"

Ligje te lidhura me mjedisin

Ligji Nr. 10081, date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", ndyshuar me ligjin nr.10.137, date 11.05.2009.

Ligji Nr. 8405, date 17/09/1998 "Per urbanistiken" ndryshuar me ligjet Nr. 8453, date 04/02/1999 dhe Nr.8991, date 23/01/2003 dhe Nr.8682, date 07/112000"
Ligji Nr. 8652, date 31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore."

Ligji Nr. 9244, date 17/06/2004 "Per mbrojtjen e tokes bujqesore"
Ligji Nr. 10081, date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", ndyshuar me ligjin nr.10.137, date 11.05.2009.

Vendime te Keshillit te Ministrave (VKM) dhe udhezime
VKM Nr.249, date 24.04.2003 "Per miratimin e dokumentacionit per leje mjedisore dhe te elementeve te lejes mjedisore"
VKM Nr.268, date 24.04.2003 "Per certifikimin e specialisteve, per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe te auditimit mjedisor."
VKM Nr.805, date 4.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore.

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr.3, date 17.08.2004 "Per miratimin e listes se veprimtarive, formatimin e aplikimit, dhe rregullat e procedurat e dhenies se pelqimit dhe autorizimit mjedisor nga ARM.

Rregullore e Ministrise se Mjedisit Nr.1, date 17.08.2004 "Per pjesemarrjen e publikut ne procesin e vleresimit te ndikimit te mjedis."

Udhezimi i Ministrit te Mjedisit Nr.5, date 28.12.2007 "Per tarifat e sherbimit per Leje Mjedisore.

Udhezimi Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie."

Udhezim i Nr.2, date 21.05.2007 "Per miratimin e listes se veprimtarive me ndikim ne mjedis, menyren e aplikimit dhe rregullat e provedurat e dhenies se autorizimit dhe pelqimit mjedisor nga Agjencite Rajonale te Mjedisit."

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr. 3, date 02.12.2013 "Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore.

Urdher i Ministrit te Mjedisit, Nr. 429, date 17.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per pajisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit.

3 - TE DHENA TE PERGJITHESHME

Shoqëria “CLAUDIO GROUP” Sh.p.k, me nr. Nipt L41419502J me administrator Z. Fuat Kapaj, do te ushtroje aktivitetin e saj ne hyrje te fshatit Vilbashtove, Kavaje. Objekti kryesor i shoqerise eshte import – ekporti i lendeve drusore, perpunim i tyre dhe prodhimi i pelletit dhe derivateve te lendes drurore, eksportin i pellet dhe i derivateve te tyre, importi i makinerive per perpunimin e lendes se pare drurore deri ne perfitimine lendes pellet. Ky aktivitet do te ushtroje nevojat e tij ne nje siperfaqe kapanon prej 1 820m². Kapanoni do te jete 1 kat + zyra 1 kat. Objekti eshte ne fazen ndertimore, me themele B/A dhe konstrukcion metalik te perbere nga kollona dhe trate te series IPE, mbulesa anesore eshte parashikuar te behet me panele sandwich 5 cm, ndersa mbulesa e kombinuar me panele sandwich andulat 8 cm dhe panele andoluxper ndricimin e ambientit te brendshem, dyshemeja e kapanonit eshte parashikuar me solete industrial. Sheshi i ndertimit do te rrethohet dhe do te mbushet me cakell per realizimin e kuotave te kullimit te ujit. Sheshi eshte menduar te sistemohet kryesisht me cakull dhe betonele ne pjesen e kalimit te mjeteve,ne pjesen e hyrjes eshte parashikuar te ndertohet nje parking dhe sistem gjelberimi ne te gjith ambientin. Ne pjesen veri-perendimore do te mbillen fidane dekorativ pergjate gjithe brinjës. Largimi i ujerave te shiut eshte parashikuar te behet me tuba F100 te vendosura pergjate kampateve te objektit. Ato do te lidhen me tubin kryesor F200, i cili perbehet nga 14 puseta shiu dhe 2 puseta kontrolli.

Siperfaqja identifikohet me Nr. pasurie 113/4. Ben pjese ne zonen kadastrale Nr. 9774, Vileballaj, Kavaje.

***Kufizimet jane:**

V me numer pasurie 113/1; **L** me numer pasurie 113/1 ;

J me numer pasurie 113/1; **P** numer pasurie 113/2.

***Koordinatat e objektit jepen si me poshte:**

Pika	X	Y
1	41° 3'21.50"N	19°31'45.77"E
2	41° 3'20.97"N	19°31'48.26"E
3	41° 3'20.04"N	19°31'47.84"E
4	41° 3'20.60"N	19°31'45.42"E

*Pamje e pergjithshme e objektit ne Google



*Pamje e detajuar e objektit ne Google



4 - RELACIONI TEKNIK

Investitori eshte duke instaluar linjen e prodhimit, pra aktiviteti ende nuk ka filluar. Linja eshte e teknologjise se fundit, gje qe do te ndikojne ne eficensen e prodhimit gjate funksionimit dhe ndikimit minimal ne mjedis.


Kapaciteti i prodhimit te linjes arrin ne 1.8 ton/ore.

Pelleti i drurit prodhohet nga kompesimi i tallashit, pluhurit te bluarjes dhe ashklave te drurit. Lenda e pare sigurohet nga mbetjet e drurit nga subjektet qe kane punishte per prodhimin e mobiljeve, nga kashta e mbledhur nga banoret e fshatrave perreth, farat e ullinjve dhe biomase qe sigurohet nga mbetje bimore te ndryshme. Shoqeria sapo te paiset me Leje Mjedisore, do te lidhe kontrata me furnitoret per sigurimin e lendes se pare.


Nese lenda e pare eshte e lagesht, ajo duhet te thahet para pelletizimit. Permbajtja optimale e lageshtise eshte 10-15 % . Permbajtja e lageshtise jep proporcionin e ujit te avullueshem ne peshen totale te materialit. Druri i bute eshte nje lende e pare per pelletin e drurit pak me mire se druri i forte per shkak te permbajtjes me te larte te 'linjines'. Kjo e fundit eshte ne j material lidhes natyral i fibrave te drurit dhe gjithashtu material lidhes i pelletit.

Nese lenda e pare per prodhimin e pelletit permban levore druri, fuqia kalorifike e tij eshte me e larte. Prodhimi i nje ton pelleti (lageshtia 7-10%) kerkon sasine e meposhtme te lendes se pare: Rreth 7m³ tallash druri (permbajtja e lageshtise 50-55%); Rreth 10m³ sasi ashklash druri (permbajtja e lageshtise 10-15%)

***Skema e linjes se prodhimit (diagrama)**



*Skema e linjes se prodhimit (3D)



*Shpjeguesi

- 1-depozita e lendes se pare
- 2-ndaresi
- 3-mulliri me cekic (copetuesi)
- 4-transportuesi pneumatik
- 5-depozita e shtypesit dhe grimcimit
- 6-shtypesi dhe kokerrzimi
- 7-transportuesi
- 8-kollona ftohese
- 9-shosha vibruese
- 10-linja e amballazhimit
- 11-thaset (qeset e amballazhimit)

*Procesi i prodhimit te pelletit perfshin fazat e meposhtme:

tharjen e mundshme te lendes se pare → bluarje → pelletizim
ftohje → shoshitje → paketim/magazinim

Procesi i tharjes kryhet ne nje thares ne forme tamburi, tharja nuk eshte e nevojshme nese lenda e pare perbehet nga ashkla apo tallash i thate. Nese tallashi eshte i lagesht ai duhet te thahet perpara bluarjes. Zakonisht per bluarje perdoret nje cekic bluares kur per prodhimin e pelletit eshte perdorur lende e pare homogjene. Ne bluarje lenda e pare bluhet ne inadhesine e nje kokrre te barabarte

te pakten me diamtrin e pelletit 6-12 mm . sidoqofte pluhuri i bluar i drurit nuk duhet te jete shume i imet per aq sa nuk ka me fibra qe pjeserisht lidhin pelletin. Bluarja dhe tharja e lendes se pare inund te kombinohejne kerkohet tharja. Ne nje bluares thares, bluaresi ndryshon madhesine e grimcave te tallashit qe eshte thare. Bluarja e ben procesin e tharjes shume me te lehte. Grimcat jane te inadhesive te barabarta dhe kane pothuaj tre njejten permbajtje lageshtie. Per aq sa lageshtia e te gjitha grimcave eshte homogjene pelleti eshte me i qendrueshem. Me shpesh per tharjen perdoret nje gjenerator gazi te ngrohte. Djegesi i tij djeg tepricat e tallashit dhe pluhurit nga procesi i prodhimit. Pelleti kompresohet ne shtypesa te sheshte ose shtypesa unazore te montuara vertikalisht. Normalisht ne kompresimin e pelletit te drurit nuk perdoren aditive por pelleti lidhet nga kohezioni i siperfaqeve te brendshme nga pjeset fibrove te grimcave dhe kryesisht nga adezioni i shkaktuar nga linjini qe eshte zbutur nga nxehtesia e larte qe clirohet gjate kompresimit. Temperatura e materialit te drurit te bluar rritet ne kompresorin e pelletit dhe materiali lidhet natyral linjin-a shkrin dhe lidh pelletin gjate ftohjes. Prandaj pelleti nuk e fiton forcen deris ate ftohet. Shtypesi gjithmone zgjidhet rast pas rasti, zgjedhje qe varet nga karakteristikat e kualitetit (fortesia, lageshtia, perberja) te lendes se pare qe do te kompresohet. Ftohja eshte nje faze shume e rendesishme e procesit. Pas kompresimit temperatura e pelletit eshet e larte rreth 90 grade celcius . lageshtia e cliruar ne fazen e kompresimit eshte larguar me nxehtesi nga produkti. Ftohja stabilizon pelletin dhe frocon linjinen e shkrire ne siperfaqen e etij dhe prandaj forma e pelletit mbetet e pandryshuar. Ne shoshitje phuhuri i lendes se pare i perzier me pelletin vecohet dhe rikthehet mbrapsht serish ne procesin e pelletizimit. Shoshitja zakonisht kryhet me nejt shoshe vibruese per te siguruar nje produkt homogjen qe nuk shkakton problem ne konvejeret dhe pajisjet djegese. Ne perfundim pelleti transportohet ne dhomen e magazinimit ose paktohet ne thase te vegjel ose te medhenj per tu transportuar direkt tek konsumatoret. Mund te magazinohet ne sasira te medha ne sillosa te madhesive te ndryshme ne varesi te nevojave.

5 - KARAKTERISITKAT E ZONES KU DO TE KRYHET AKTIVITETI

***Popullsia**

Popullsia e kesaj zone eshte 50% autoktone dhe 50% e ardhur pas viteve 90. Statistika te sakta per kete popullsi nuk jane publikuar por eshte nje popullsi pergjithesisht e re me nje numer popullsie rreth 6500 banore. Infrastruktura e rruges eshte ne gjendje te mire. Ne kete zone eshte ekzistues rrjeti i kanalizimeve dhe i shperndarjes se ujesjellesit nderkohe qe prane prones nga ana e rruges kalon rrjeti i tensionit te mesem elektrike. Ne sheshin e ndertimit ka tubacione te furnizimit me uje, si dhe te rrjete te telefonise se telekomit.

***Trashegimia kulturore**

Nga konstatimi ne zone, territori ne studim nuk ndodhet ne distanca te aferta me zonat e mbrojtura nga Instituti i Monumenteve te Kultures. Ne zonen e kerkuar per shfrytezim nuk ka objekte arkitektonike, arkeologjike, kulturore dhe me interesa historike, ato ndodhen ne largesi te mjaftueshme me zonen ne studim ku as ne menyre direkte dhe as indirekt nuk ndikon ky studim ne zone te mbrojtura si Monumente te Kultures.

***Terreni dhe vendet me pamje te vecante**

Terreni i ketij zone eshte fushore. Nga lindja dhe verilindja ndodhet nje sistem kodrinor i bute me lartesi deri ne 80 m deri ne 450 m lartesi nga niveli i detit) i kultivuar me foragjere, peme frutore (veganerisht me ullinj dhe vreshta) si dhe me shkurre mesdhetare me nje bimesi mesatare. Pamjet piktoreske te rruges jane ato te nje terreni te larmishem bujqesor, i fragmentizuar, me bime bujqesore (foragjere dhe drithera) si dhe me plantacione te kufizuara mollesh, pjeshkesh dhe sera diellore.

Nuk vecohet per ndonje peisazh te vecante dhe as per perdorim si mjedise ku banoret kalojne fundjaven. Kjo zone ka nje peisazh te thjeshte pa ndonje vecori. Ne kete siperfaqe ka ndertesa ekzistuese, eshte nje zone komerciale dhe objektet e banimit ndodhen ne distanca te aferta nga objekti por larg objekte me densitet te larte.

***Klima**

Klima e rajonit eshte mesdhetare fushore qendrore me karakteristikat klimaterike te rajonit te Shqiperise Perendimore. Zona dallohet per dimera te buta me karakteristika te theksuara mesdhetare dhe vetem ne raste te rralla ashpersia e dimrit eshte e ndjeshme. Si gjithe zona mesdhetare ne pergjithesi ka nje sasi te konsiderushme kohe me diell. Kjo arrin ne 2560 ore ne vit me maksimumet ne muajin korrik me 360 ore dhe minim 100 ore ne dhjetor.

Presioni atmosferik sipas te dhenave shume vjecare leviz nga 752-753 milimetra, (1002,6 - 1003,9m bar). Vlerat e temperatures se ajrit ne pergjithesi jane te qendrueshme. Periudha me temperatura mesatare me te madhe se 7°C zgjat afersisht 10 muaj.

Zona ne studim perfshihet ne zonen klimaterike mesdhetare fushore qendrore. Temperatura mesatare vjetore leviz nga 15°-16°C. Amplituda e ndryshimeve midis dites dhe nates eshte e ndjeshme dhe leviz nga 6 deri ne 12-14°C. Lageshtia mesatare relative e ajrit arrin ne rreth 70%.

Sipas te dhenave shumevjecare statistikore te sherbimit hidrometeorologjike, sasia mesatare vjetore e shiut arrin ne 1247mm. Numri i diteve me rreshje me te madhe se 10mm leviz mesatarishte nga 85-100 dite.

Era fryn pergjithesishte ne dy drejtime gjate gjysmes se ftohet te vitit, ku vihet re se mbizoterojne ererat jugelindjore, pa perjashtuar ererat veriore. Ndersa ne gjysmen e ngrohte te vitit mbizoterojne ererat veriperendimore.

Tabele 1. Shpejtesise se eres ne stine te ndryshme per rajonin e Tiranes.

Stacioni	Dimer	Pranvere	Vere	Vjeshte	Vjetore
Tirane	1.8	1.8	1.7	1.5	1.7

***Sizmiciteti**

Trualli Shqiptar vendoset gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kunder tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe eshte vater e perqendruar termetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues. Tirana eshte zone e prekur nga termetet, ku nga pikepamja sizmoteknike zona mund te goditet nga termete me magnitudo $M_{max}=5.5-6.0$ grade Richter me intensitet deri ne 7 bale MKS-64 e cila shkakton garje ne mur dhe rrezim te copa te suvash por per objektet e ulte nuk parashikohen shqetesime. Si dhe mundesite per te goditur termetet me shume balle jane te vogla rreth 20%.

***Gjeologjia dhe Dherat**

Shqiperia si formacion gjeologjik eshte pjese perberese e rrudhosjeve alpino-mesdhetare pjese e degezimit Dinaro-albano-Helenid, ku ne bejme pjese tek Albanidet. Kavaja si zone e jashtme ben pjese ne Ultesiren Paramalore, dhe ndodhet ne krahinen e ultesires perendimore, dhe karakterizohet nga shkembinj te dobet qe i ben te paqendrueshem nga rreshqitja dhe eshte pjese e sistemit neogjenik argjila, konglomerat ranor. Zona karakterizohet nga brezi i tokes se hirte kafe, ku ajo vendoset mbi formacione sedimentare dhe sasia e humusit eshte e vogel rreth 2-4%. Ne sheshin e ndertimit marrin pjese formacione te neogjenit

te perfaqesuara nga nderthurje alevrolitesh argjilore e ranore si dhe nga depozita aluvilo-deluviale te kuarternit, trashesia e te cilit arrin deri ne 25-30 m.

***Hidrologjia, ujrat siperfaqesore dhe nentokesore**

Ne kete rajon takohen ujerat nentokesor ne depozitat zhavorr. Niveli i ujit nentokesor eshte 3.80m nga siperfaqja e tokes por ne puset e shpimit ai arrin te ngrihet dhe te stabilizohet ne 0.6-0.8 m thellesi dhe ne varesi te stines niveli i tyre ndryshon. Pasqyra e nivelit te perhershem te ujerave nentokesor luhaten sipas rreshjeve.

Ne zonen ku do te realizohet projekti verehet se nuk ka burime siperfaqesore ne distanca te aferta. Ne zonen e shfrytezimit dhe perreth saj nuk ka zona te lundrueshme dhe nuk ndodhen liqene dhe dete, prandaj gjate shfrytezimit nuk do te cenohen rruget ujore, brigjet bregdetare etj. Ne konturin anesor te zones dhe ne pjesen lindore te prones ne studim vihet re ish kanalet e drenazhimit qe kane ekzistuar per keto toka are dhe truall.

***Mjedisi biologjik**

Vegjetacioni qe takohet ne kete zone kodrinore dhe fushore eshte tipik i mjediseve te ulta e kodrinore, anash rrjedhjeve ujore-kanaleve kullues te tokave bujqesore. Karkteristika e pare e tij eshte plasticiteti i larte ekologjik i shoqerimeve qe pasqyrohet qarte ne perberjen floristike te tij. Flora e habitatit te marre ne konsiderate (Toka te punuara) eshte e varfer ne lloje dhe monotone. Hapesira paraqitet e ekspozuar ndaj rezatimit te diellit. Numri i llojeve ketu eshte i ulet dhe ato jane direkt te kercenuara nga veprimtaria e njeriut. Duhet te nenvizojme faktin se perdorimi i pesticideve dhe herbicideve per nje kohe te konsiderueshme ka afektuar ndjeshem larmine biologjike te territorit te mare ne konsiderate. Nga familjet me te takueshme, me nje numer me te madh bimesh jane: Compositae, Graminae, Leguminosae, Cruciferae, Papaveraceae, Poligonaceae, Convolvulaceae dhe Primulaceae.

Lloji me i dendur ne mbi 40% te nje rilevimi shume te shpejte eshte Papaver rhoeas dhe me pas permendim llojet: Avena sterilis, Lactica seriola, Alopecurus myosuroides, Sinapis arvensis, Capsella bursa-pastoris, Sonchus vulgaris, Anagalis arvensis, Madicago lupulina etj.

***Zona me rendesi te vecante:**

Territori ne studim nuk eshte e perfshire ne menyre te drejtperdrejte ne zone te mbrojtur apo zone buferike, te cilat ruhen ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi. Zona ne studim nuk bene pjese ne zonat e mbrojtura me interes nderkombetar apo te cenoj ndonje nga konventat e nenshkruar.

6 - GJENERIMET E NDOTJEVE NE MJEDIS, MASAT PER ZBUTJEN E PARANDALIMIN E TYRE

***Mbetjet e ngurta**

Gjate zhvillimit te aktivitetit do te gjenerohen mbetje te ngurta te cilat nuk perbejne rrezik per ndotjen e tokes. Keto mbetje vijne nga aktiviteti i pergjithshem i personelit apo ato te tipit ambalazh, si qese, thase plastike, kartona etj. Sapo subjekti te marre lejet perkatese per zhvillimin e aktivitetit, ai do te lidhe kontrate me pushtetin vendor per te derguar keto mbetje ne vende te percaktuara per komunen ose do te kontaktoje me shoqeri riciklimi.

***Mbetje organike**

Gjate ketij aktiviteti nuk kemi gjenerim mbetjesh organike, pasi e gjithe lenda e pare organike futet ne ciklin e prodhimit te pelletit. Tepricat qe dalin nga cikli i prodhimit, futen serish ne prodhim

***Mbetje te gazta**

Nuk gjenerohen mbetje te rrezikshme te gazta, kemi vetem clirim te avujve gjate tharjes dhe pluhurave te tallashit. Keto do te kapen me ane te sistemit te ventilimit qe do te instalohen ne objekt, te paisur me filtra pluhur kapes. Ne dalje te ajrit do te vendoset nje mates te nivelit te pluhurit. Filtrat do te nderrohen cdo muaj dhe do te mbahen regjistra per nivelin e pluhurave qe gjenerohen.



***Mbetjet e lengshme**

Ne kete process nuk kemi uje teknologjik. Procesi nuk kerkon perdorimin e ujit, pasi lenda e pare futet e thate per prodhim. Persa i perket ujerave te reshjeve si dhe atyre te perdorimit nga personeli ato do t'i bashkohen kanalizimit kryesor te zones.

Shkarkimet e pritshme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithe perpresite qe ka ky proces teknologjik, duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te proceseve te punes. Masat qe duhen konsideruar per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:

- a) Duhet te tregohet kujdes ne respektimin rigoroz te kushteve teknike ne object per te reduktuar mundesite e renies se zjarrit ne objekt. Lenda e depozituar eshte djegshme.
- b) Mbetjet te grumbullohen dhe te dergohen per perpunim nepermjet mjeteve te pershtatura per kete qellim.
- c) Lidhur me mbetjet e grumbulluara dhe produktet e prodhuara duhet qe kompania te kete nje database te sasieve qe grumbullohen si dhe te produktit te shitur.
- d) Sasia magazinuese te mos i kaloje volumet e parashikuara ne menyre qe situata te jete e kontrollueshme.
- e) Te zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarret ne menyre qe te perballoje sasine e depozituar te lendes djegese ne raste te avarive te ndryshme.

7 - PLANI I MONITORIMIT TE MJEDISIT

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, derdhjeve urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore persa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv. Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasimore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi eshte detyre e investitorit per pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 te VKM Nr. 1189, date 18.11.2009 "Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise".

Plani i monitorimit mjedisor eshte i inkorporuar ne projekt dhe perfshin inspektime dhe raportime rutine. Me poshte do te paraqesim disa monitorime qe do te realizohen per treguesit e trysnise ne mjedis qe jane detyre e investitorit ku ai do te bashkepunoje me institucionet perkatese.

Monitorimi i cilesise se ujit: monitorimi i ujit te zones duhet te kryhet para se te filloje ushtrimi i aktivitetit ne menyre qe te behen krahasimet gjate fazes se

shfrytezimit. Shoqeria investitore duhet te kryej monitorime te ujit 1 here ne vit dhe duhet ti dorezoje ne Agjencine Kombetare te Mjedisit. Keto monitorime duhet te konsistojne ne analizat fiziko-kimike te ujerave te perdorur, pH, klorigen i lire, Nevojen kimike per oksigjen NKO, nese do te perdoren ujera per procesin e punes. Ne kete detyrim perjashtohen ujerat higjeno-sanitare te aktiviteti njerezor (Kjo nese aktiviteti ka shkarkime te ujerave te perdorur).

Monitorimi i cilesise se ajrit: monitorimi i cilesise se ajrit si edhe faktoret mjedisor te permendur me siper duhet te kryhet 1 here ne vit dhe duhet te dorezohet ne Agjencine Kombetare te Mjedisit. Aktiviteti perfshin procese te djegies dhe si rrjedhoje eshte i detyruar te kryej monitorim te parametrave te cilesise se ajrit.

Shoqeria duhet te investoje ne sistemin e aspirimit ne kapanon duke siguruar nje mbrojtje te shendetit te punetoreve ne ambientin e punes nga aromat e pa kendshme te cilat mund te emetohen nga lenda e depozituar. Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar te gjitha ndotjet e mundshme qe do ti shkaktohen mjedisit nga punimet ne kete aktivitet.

8 - PLANI I PERBALLIMIT TE EMERGJENCAVE E AKSIDENTEVE

***Sigurimi teknik**

Mbrojtja e shendetit dhe siguria ne pune jane ne qender te vemendjes te shoqerise. Per te mbajtur nje regjim te forte te sigurise ne pune dhe shendetit te plote te punonjesve do te merren masat e meposhtme:

Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen

Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion

Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre

Masat per mbrojtjen nga zjarri do te jene pjese e instruktiveve e te tabelave lajmeruese e parandaluese. *Programi i menaxhimit te **ndikimit** ne mjedis qe ka aktiviteti i pikes se karburantit

Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga elementet e pershkruar me siper, Investitori nepermjet personelit te tij ka perpiluar dhe do te zbatoje nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis. Filozofia e ketij plani mbeshtetet ne keto parime te zbatueshme:

***Renia e zjarrit**

Ne rastet e renies se zjarreve, ne territorin e Pikes se karburantit eshte afishuar skema e lajmerimit. Mbi bazen e kesaj skeme personeli qe ndodhet ne Piken e karburantit vepron duke bere njoftimin e PMNZSH ne numrat e zjarrfikseve te afishuara ne tabelat perkatese. Brenda Pikes se karburantit do te funksionoje edhe lidhja telefonike dhe telefonat celulare qe do te vihen ne dispozicion per lajmerimin e zjarrfikses. Personeli prezent bazuar ne skemen teknologjike te depozitave vepron menjehere me fikeset e dores dhe tenton te kufizojte perhapjen e metejshme te zjarrit e rezervuaret e tjere duke mbyllur rruget e kalimit ne tubacionet lidhes.



			Suitable for Class B and Class C fires but not Class A
			Suitable for Class A fires but not Class B or Class C
			Suitable for Class A and Class B fires but not Class C

***Renia nen tension**

Duke u nisur nga specifika qe ka puna me karburantet e lengshme e te gazta, te cilat ne prani qofte edhe te nje shkendije te vogel ndizen, ne Piken e karburantit eshte marre ne konsiderate edhe mbrojtja nga renia nen tension e pajisjeve dhe personelit.

Po keshtu jane percaktuar veprimet e menjehershme ne raste te tilla.

***Shkarkimet atmosferike**

Edhe shkarkimet atmosferike jane nje burim potencial i renies zjarrit ne objekt. Te gjitha objektet me lartesi si shtylla ndricimi dhe shtyllat e furnizimit me energji elektrike ajrore jane te perfshira ne sistemin e mbrojtjes nga renia nen tension, keshtu qe ky system kryen edhe funksionin e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.

9-REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE

*Edhe pse ne raportin e VNM, investitori ne bashkepunim me hartuesin e VNM, ka parashikuar masat qe do te marre per minimizimin e efekteve negative ne mjedis, si dhe menaxhimin e ndotjeve qe priten te gjenerohen nga zhvillimi i aktivitetit, bazuar dhe ne legjislacionin ne fuqi, i rekomandojme shoqerise si me poshte:

Te merren masa per te parandaluar renien e zjarrit dhe te sigurohen mjetet e nevojshme te nderhyrjes ne rast te renies se zjarrit (depozite uji, zjarrefikese te levizshme etj.)

Te vazhdoje gjelberimi i territorit sidomos me peme me gjelberim te perhereshem ne perimetrin rrethues te saj.

Te mbahet ne gadishmeri te plote sistemi me furnizimin e ujit.

Gjate ushtrimit te aktivitetit, do te mbahet nen kontroll ndotja e ajrit brenda nivelit 90 mikrogram/m per pluhurin total (LGS) dhe 50 mikrogram/m per pluhurin e frymemarrjes (PM10).

Mbeturinat gjate ushtrimit te aktivitetit, do te grumbullohen, transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara nga pushteti vendor.

Te mbahet nje regjister periodik mbi shkarkimet dhe rezultatet e analizave.

Te mbahen kontaktet me DRM Tirane, ne menyre periodike, duke dorezuar prane saj raportet e vetemonitorimit

Gjate zhvillimit te procesit te punes, do te behet pluhur i lehte nga levizja e automjeteve, si rrjedhoje drejtuesit kane marre masa per pastrimin e objektit.

Ne ambjentet e punes do te zbatohen rregullat e sigurimit teknik ne pune dhe do te punohet per krijimin e kushteve optimale te punes.

Zhvillimi i aktivitetit nuk sjell ndotje te mjedisit, ujerat qe perdoren per larjen e dyshemese drejtohen drejt rrjetit UK te qytetit.

Do te ruhen me rigorozitet kushtet e higjienes ne ambjentet e punes, si dhe do te zbatohen rregulloret per masat kunder zjarrit dhe planit te emergjencave.

*Projekti per Riciklim te mbeturinave te drurit, tallashit, berthames se ullirit, prodhim PELLETI, magazinim dhe tregtim me shumice e pakice ndertimin e linjes se me kapacitet perpunimi deri 1.8ton/dite, eshte hartuar mbi bazen e teknologjise me te mire te mundshme ne fushen perkatese.

Zbatimi i ketij projekti do te kontribuojte ne nje rritje ne nivel lokal e kombetar, si dhe ne rritjen e mundesive per vende te reja pune.

Projekti nuk ka shkarkime ne mjedis dhe ndihmon organet shteterore te ruajne cilesine e mjedisit. Kjo veprimtari ul shpenzimet e shtetit per asgjesimin me menyra te tjera te mbeturinave te drurit, tallashit, e cila perben shqetesimin kryesor per shkak te kohes se gjate te dekompozimit deri ne 100 vjet.

*Mbi bazen e konstatimeve ne kete Raport te Vleresimit te Ndikimit Mjedisor te performances se projektit sugjerojme te merren masat e meposhtme:

1. Ngritjen dhe zhvillimin e nje sistemi te menaxhimit mjedisor ne perputhje me kerkesat e ISO 14001 dhe te legjislacionit Shqiptar per mbrotjen e mjedisit.
2. Mbetjet e ngurta urbane dhe mbeturinat (llumrat) qe krijohen gjate aktivitetit te grumbullohen e evadohen ne vendin e caktuar nga njesia vendore.
3. Te shtohet gjelberimi ne ambjentet e jashtme.
4. Nderhyrjet ne rrjetin e infrastruktures te kryhen me lejen e institucioneve perkatese.
5. Te realizohet ndricimi perreth (vendosja e instalimeve te ndricimit)
6. Te respektohen standardet e normativat per nivelin e lejuar te zhurmave.

10 - SHTOJCAT

Tabele 1: Lendet e para

Lendet e para	PO		Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A perdorni lende te para?	Po		Pasi aktiviteti ne vleresim eshte per rrijte te shendeve, ne pjesen teknike eshte percaktuar kapaciteti i tyre dhe tipi perkates
A perdorni materiale ndihmese?	Po		Perdoren shitesa elementesh per ushqyerjen e tyre
A perdorni perzierje materialesh?	Po		Perdoren produkte te gatshme per ushqyerjen e tyre
A perdorni lende djegese (dhe/ose energji)?	Po		Energji elektrike e cila perdoret per ndricimin e mjediseve te punes dhe njesise se rritjes se shpendeve
A perdorni kimikate sintentike/laboratorike?		Jo	Nuk perdoren elente sintetik pasi eshte proces ku perdoren vetem lende organike

Tabele 2: Perdorimi / sigurimi i energjise

Perdorimi / sigurimi i energjise	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A perdorni energji?	Po		Kapaciteti i konsumit te energjise elektrike varion sipas muajve dhe kapaciteve ditore perpunues, nje mesatare mund te arrij deri 7490KW
A perdoret kjo energji ne territorin e impiantit apo sigurohet nga burime te tjera?		Jo	Kjo sasi e energjise elektrike perfitohet nga shpendarja konform nje kontrate te lidhur midis dy paleve
Konsumi I lendeve djegese per sigurimin e energjise nese prodhohet ne impiant/instalim?		Jo	Nuk prodhohet ne kete instalim.
Informacion tjeter sqarues?			N/A (jo i aplikuar)

Tabela 3: Konsumi i energjise dhe ujit

KONSUMI I ENERGIJISE	
Burimi	Konsumi ditor dhe total ne baze viti (kwh/g, t/g, dhe te ngjashme)
Energjia elektrike	7490KW
KONSUMI I UJIT	
Burimi I furnizimit	Konsumi ditor dhe total ne baze viti (m ³)
Rrjeti public	
Pus personal	
Informacion tjeter sqarues?	1000 m ³ / dite (linje teknologjike ekzistuese)

INFORMACION I DETAJUAR PER SHKARKIMET NE MJEDIS

1.1. Shtojca II: Shkarkimet ne mjedis dhe mbetjet

Shkarkimet ne ajer

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime ne ajer?		Jo	Nuk ka proces teknologjik vetem aroamt e keqija nga stallat
A ka shkarkime ne ajer (nga burime te shperndara)?		Jo	Pasi perdoret me energji elektrike te cilet nuk shkaktojne ndotje ne mjedis
A ka erera te keqija nga shkarkimet?		Jo	Ne vleresim qe u be ne terren, nuk u konstatuan aroma te pakendshme jashte normave te lejuara

Shkarkime te ujerave te ndotura

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime te ujrave te ndotura?	Po		Ujerat e ndotura te zeza nga sistemi i vete objektit per nevoja sanitare
A ka ujera te ndotura me natyre toksike?		Jo	Ky aktivitet nuk eshte aktivitet qe perdor element te rrezikshme per mjedisin dhe shendetin e punonjesve
A behen shkarkime ne rrjetin e kanalizimeve?	Po		Zona eshte nje zone ekzistuese ku kane ekzistuar sistemet e kanalizimeve
A behen shkarkime ne siperfaqen ujore?	Po		Por kjo eshte pasi grumbullohen ne kolektorin kryesor te zones, per te cilen

			pergjigjet KUZ
Jepni sasine e ujerave te ndotura (m ³ /dite)	1000m3/dite		

Zhurma & vibracionet

Pyetjet	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen zhurma?	Po		Nga procesi i zakonshem i pune por ne nivele te moderuara
A gjenerohen vibracione?		Jo	Procesi nuk ka te bej me vibrime por me nje proces te thjeshte pune

Mbetjet e ngurta

	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen mbetje te ngurta?	Po		Rryma e mbetjeve organike, plastike, qelq, leter, lende organike etj
A gjenerohen mbetje te ngurta te rrezikshme?		Jo	Ky aktivitet nuk eshte aktivitet qe perdor element te rrezikshme per mjedisin dhe shendetin e punonjesve
Te asgjesuara ne territorin e impjantit/instalimit?		Jo	Mbetjet organike depozitohen ne venddepozitimin e percaktuar nga Komuna dhe mbetjet e ricikluese eshet lidhur kontrate me kompanite qe grumbullojme mbetje te riciklueshme

Burimet e shkarkimit ne ajer: SIPAS MONITORIMIT BASHKELIDHUR

Jepni periudhen ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke perfshire variacionet ditore ose sezonal (jepni informacion se kur ka qene venia ne pune dhe/ose nderprerja e punes):

Kohezgjatja e shkarkimit (mesatare)	Min/ore	Ore/dite	Dite/vit

Clirimi i zhurmes ne mjedis

	Sistemi Koordinative UTM (3 Veri, 3 Lindje)	Niveli i zhurmes /db (A)		
		L(A)eq	L(A)i0	L(A)90
Mjediset/Godinat e instalimit/impiantit:				
Vendodhja 1:	382328.00 m E 4504281.00 m N	55		
Vendodhja 2:	-			
Vendodhja 3:	-			
Vendodhjet e ndjeshme te zhurmes:				
Vendodhja 1:	N/A			
Vendodhja 2:	n/a			
Vendodhja 3:	N/A			

Shkarkimet e ujerave te ndotura

Pika e shkarkimit:

Nr. Ref. I pikes se shkarkimit (numri referues duhet te jete i njejte me numrin e shkruar ne harten e instalimit/impiantit)	Pika 1: Pika e shkarkimit ne kolektorin e zones
Burimin i shkarkimit:	Ujera te ndotura urbane sanitare nga sistemi kanalizime
Vendodhja:	Kolektori i zones
Koordinatat ne Sistem UTM	382318.00 m E 4504242.00 m N

Emri/Emertimi i marresit (lumit, liqenit...):	Perrua i zones
---	----------------

Informacion i detajuar per shkarkimet e lengta

Sasia e shkarkuar			
Mesatare/dite	800m ³	Sasia maksimale/dite	1000m ³
Sasia maksimale/ore	m ³		

1 ore/dite

dite/vit

Periudhat e shkarkimit (mesatare) min/ore

Karakteristikat e shkarkimeve te ujerave te ndotura

Parametri	Perpara trajnimit				Nga vendi i lirimit/leshimit pas shkarkimit			
	Mesatarja max.0a e max. vleres/ore (mg/l)	Mesatarja e max. vleres ditore (mg/l)	Kg/vit	Kg/vit	Vlera mesatare maks. Ne ore (mg/l)	Vlera ditore maks. Ne ore (mg/l)	Kg/vit	Kg/vit

Shenim: Nuk eshte monitoruar si aktivitet

Jepni periudhen ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke perfshire variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qene venia ne pune dhe/ose nderprerja e punes):

Shotjca III: Kapja dhe trajtimi i ndotjes dhe shkarkimeve ne mjedis dhe mbetjeve

Trajtimi i ndotjes

Lloji shkarkimit/ndotjes (neter, ajer, toke, uje)	Pershkrimi i trajnimit
---	------------------------

Ne uje	Do te perdoret sistem septik standard me tre ndarje dhe sistem grile me mjediset e pune pasi ujerat jane vetem te ngarkuar me mbejte te ngurta si mbejte organike, leter, qelq, etj
Ne Toke	Nuk ka ndotje
Ne ajer	Nuk vlersohet e nevojshme pasi jave vetem avuj uji pasi perdoret gaz i lengshem dhe energji elektrike

2. Menaxhimi i mbetjeve

Materia le mbetjes h	Numri nga Rregullorja per Kategorit e e Mbetjeve , duke perfshire listat	Vendi kryesor I gjenerimit	Sasia		Trajtimi ose asgjesimi instalim/imp iant (Metoda dhe vendodhja)	Trajtimi, rikuperimi riciklimki ose asgjesimi jashte instalimit/imp ianti (Metoda, vendi, kontraktori)
			Ton/mu aj	m ³ /mu aj		
Vajra te perdoru r	12 01 10*	Njesia e sherbimi t te automjet eve	0.5		Kontraktor te licensuar	Riciklim (Proces kimik trajimi sekondar)
Qelq	19 12 05	Zyrat dhe sherbimi	0.05		Kontraktore	Riciklim
Lende organik e	16 03 06	Mjedisi i perpuni mit	0.1		Vend grumbulli urban	Komuna
Metale dhe metalor e	19 12 02 19 12	Zyrat dhe sherbimi	0.02		Kontraktore	Riciklim

	03Metale					
	joferrore					
Plastik dhe gome	19 12 04	Zyrat dhe Sherbimi	0.01		Kontraktore	Riciklim

Programi i vetmonitorimit te shkarkimeve ne vijueshmeri per Vitin 2014
Vendodhja e monitorimit/Koordinatat ne Sistemin e Koordinimit UTM:

Parametri ¹	Rezultatet (mg/l ose mg/m ³)				Metoda e marrjes se mostres	Qellimi/arsyeja vleresimit analitik	Metoda e analitike / teknika
	Data	Data	Data	Data	Me instalim te levizshem	Vleresim impaktit	ilartesia 8.4 ml
CO	05.07.2008				Po	87 mg/m ³	Me tubea Ind.
NO2	05.07.2008				Po	120 mg/m ³	Met. Me tubea Ind. Dhe metode kimike me TEA

Punoi: Besim Doci

Ekspert mjedisor i licensuar nga Ministria e Mjedisit

Nr. 168 Prot, date 02.09.2005

Vendimi Nr. 8, Nr. 155 Regjistri